

Plani i Konsultës me Publikun dhe Bërjes Publike të Projektit të Terminalit të PIA-s në Vlorë

1 HYRJE

1.1 Qëllimi

Qëllimi i Planit të Konsultës me Publikun dhe Bërjes Publike të Projektit është të bëjë një prezantim të shkurtër të Projektit dhe të paraqesë planin për konsultën me publikun dhe bërjen publike të projektit gjatë të gjithë hapave të planifikimit, ndërtimit, operimit dhe çmontimit. Ai përshkruan publikun që mund të preket nga projekti, si funksionon komunikimi gjatë procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor, si dhe çfarë informacioni do të bëhet publik në gjuhët përaktëse dhe me çfarë mjetesh.

1.2 Përshkrimi i Projektit

Një terminal i ri bregdetar është planifikuar të ndërtohet dhe operohet nga La Petrolifera Italo Albanese ("PIA"), degë e La Petrolifera Italo Rumena ("PIR"), në Gjirin e Vlorës në Jug të Shqipërisë. Terminali do të depozitohet hidrokarbure të lëngshëm, gaze të lëngëzuara të naftës (GLN) dhe produkte të tjera të lëngshme, kryesisht kimikate. Fasilitetet e terminalit do të ndërtohen në tre faza.

Terminali në fazën 1 përbëhet kryesisht nga një numër çisternash për depozitimin e hidrokarbureve të lëngshme dhe GLN (Gaze të Lëngëzuara të Naftës) dhe produkte të tjera të lëngshme, së bashku me aparaturo ndihmëse të përshtatshme për ngarkimin e autoçisternave dhe vagon-çisternave dhe një infrastrukturë detare për ankorimin dhe shkarkimin e anijeve çisternë. Është parashikuar gjithashtu mundësia për të marrë produktet në rrugë tokësore dhe ngarkimi i anijeve çisternë. Anijet çisternë do të ankorohen në një pontil dhe do të shkarkohen nëpërmjet krahëve ngarkues ose tubave fleksibël; produktet e lëngshme do të depozitohen në çisterna të depozitimit në presion atmosferik dhe GLN do të depozitohet në çisterna cilindrike ose sferike nën presion. Terminali do të jetë në gjendje të përmbushë në fazën e parë një kërkesë tregu prej 50.000-60.000 ton në vit GLN dhe 300.000-400.000 ton në vit gazoil dhe benzinë. Transportimi i produkteve në rrugë tokësore me anë të auto-çisternave dhe rrugë hekurudhore me anë të vagon-çisternave do të sigurohet në një numër të përshtatshëm stacionesh ngarkimi të dedikuar të pajisuar me krahë ngarkues dhe matësa të volumit apo masës.

Fasilitetet në breg dhe infrastruktura detare do të realizohen në tri faza/dy stade të përshkruara më poshtë, afati kohor i të cilave varet kryesisht nga tendenca afatmesme/afatgjatë e konsumit të produkteve të naftës në Shqipëri.

Pjesa Tokësore e Terminalit:

Faza e parë

- Një kapacitet i përgjithshëm depozitimi prej 37.000 m³ për gazoil dhe benzinë i përbërë nga:
 - Gazoil: 5 çisterna (TK 001÷005) me një kapacitet depozitimi të përdorshëm prej 5.000 m³ secila për një total prej 25.000 m³.
 - Benzinë: 4 çisterna (TK 011÷014) me një kapacitet depozitimi të përdorshëm prej 3.000 m³ secila për një total prej 12.000 m³.
 - Një kapacitet depozitimi të përgjithshëm GLN prej 6.000 m³ i përbërë nga 3 çisterna sferike (V001÷V003) me një kapacitet depozitimi prej 2.000 m³ secila.

Në këtë fazë, PIA do të autorizohet gjithashtu të ndërtojë kapacitet shtesë për GLN dhe vaj solar dhe/ose gazoil dhe/ose produkte të tjera të rënda, të cilat do të ndërtohen vetëm në rast

se i shërbejnë nevojave të termocentralit të ri të planifikuar të Vlorës ose kërkesave të vërtetuara të ekonomisë shqiptare siç parashikohet në Marrëveshjen e Konçesionit të Terminalit. Kapaciteti i përmendur do të perbehet si më poshtë:

- 3 çisterna me kapacitet depozitimi neto secila prej 13.000 m³ (TK 020), 10.000 m³ (TK 021), 3.000 m³ (TK 022) për naftë bruto dhe vaj solar në qoftë se nevojiten dhe kërkohen në kohën e duhur nga klientë potencialë të Terminalit.

Çisternat për produkte të lehta (benzina) do të pajisen me çati lundruese me një hermetizim të dyfishtë periferik, për të arritur një emetim absolutisht të neglizhueshëm të përbërësve të avullueshëm organikë (VOC) gjë që e bën operimin jashtëzakonisht të sigurtë. Për më tepër stacionet e ngarkimit të benzines do të pajisen gjithashtu me një system rekuperimi të efektshëm të VOC. Ujrat rrjedhës, të cilët mund të bëhen me naftë do të veçohen dhe do t'i nënshtrohen një trajtimi fizik dhe kimik për të përmbushur standardet e pritshme të cilësisë për ujrat rrjedhës që derdhen në det.

Faza e dytë dhe e tretë

Kompania planifikon të zmadhojë kapacitetin depozitues për produkte të bardha të lëngshme dhe GLN, në varësi të kërkesës së tregut. Aktualisht, është parashikuar të zgjerohet gradualisht kapaciteti për produkte të naftës deri në 64.000 m³ (plus 26.000 m³ shtesë, të cilat mund të realizohen për nevoja specifike të ekonomisë shqiptare) dhe të GLN deri në 22.000 m³. Për produkte kimike është planifikuar një kapacitet depozitues shtesë prej 10.000 deri në 20.000 m³. Zbatimi i këtyre fazave varet nga nevojat e ekonomisë shqiptare dhe nga zhvillimi i tregut. Është marrë parasysh instalimi i kapaciteteve të mëtejshme depozituese të produkteve të lëngshme të bardha dhe të zeza dhe të GLN, ndërsa zhvillimi i depozitave kimike është përfshirë në planimetrinë e terminalit dhe marrë parasysh në lidhje me projektimin e infrastrukturës për të lejuar një zbatim të lehtë të këtij zhvillimi pa probleme përsa i përket planimetrisë dhe lidhjeve. Në pontil ka vend mjaftueshëm për instalimin e ardhshëm të tubacioneve dhe krahëve shkarkues/tubave të lidhjes.

Infrastruktura Detare:

Stadi 1

Terminali do të pajiset me një pontil të vendosur në fundin e një kanali hyrës me një thellësi lundrimi prej 10 metrash për anije-çisterna deri në rreth 15.000 DWT. Pontili do të jetë i hapur me një platformë të mbështetur mbi pilota dhe do të jetë i mbrojtur nga lëvizja e valëve dhe mbushja e përshpejtuar e shtratit të thelluar të detit, nëpërmjet barrierave të përshtatshme valëthyese (skoljerave). Bankina do të jetë rreth 150 metra e gjatë, me zonën e ankorimit që sheh nga jugu me një tjetër gjatësi prej 110 metrash.

Stadi 2

Infrastruktura detare: parashikohet që të thellohet fundi i detit në kanal dhe në akuariumin e evoluimit të anijeve deri në një thellësi prej 12.5 m në mënyrë që të mund të akomodohen anije-çisterna deri në 20.000 DWT pa kufizim dhe deri në 30.000 DWT në kushte të mira moti dhe në varësi të përmasave të anijeve.

Bankina do të ndërtohet hap mbas hapi deri në gjatësinë e parashikuar prej rreth 650 metrash. Përmbushja e Stadi 2 të Infrastrukturës Detare mund të ndahet në hapa të ndryshëm, në lidhje me shtratit dhe thellësinë e gërmimit për të përmbushur ndonjë rritje të ardhshme të konsumit të produkteve të naftës më të lartë se ai i parashikuar.

2 KONSULTA ME PUBLIKUN GJATË VNM

2.1 Grupet e interesit

Identifikimi i grupeve të interesit ndërmerret për të përcaktuar të gjitha organizatat dhe individët të cilët preken drejtpërdrejt ose indirekt (pozitivisht ose negativisht) nga zhvillimet e sugjeruara dhe të cilët mund të jenë të aftë të kontribuojnë në programin e punës nëpërmjet ekspertizës dhe/ose eksperiencës së tyre në rajon.

PIR ka punuar në Shqipëri për disa vjet dhe gjatë kësaj kohe ka zhvilluar bashkëpunime të forta me shumë nga grupet rajonale të interesit. Grupet e interesit të projektit u identifikuan në bazë të njohurive lokale për të siguruar një përfshirje sa më të gjerë të mundshme në programin e konsultës me publikun dhe bërjes publike të projektit.

Grupet e mëposhtme të interesit duhet të përfshihen në procesin e VNM-së dhe të njoftohen dhe konsultohen për projektin:

- Përfaqësues të organizmave të qeverisë qendrore
 - Ministria e Mjedisit
 - Ministria e Industrisë dhe Energjisë
 - Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit/ Instituti i Transportit
 - Anëtarët e Parlamentit
 - Komisionet Parlamentare të Ekonomisë, Industrisë, Shëndetit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Autoritetet Lokale
 - Agjensia Rajonale e Mjedisit e Vlorës
 - Autoriteti Portual i Vlorës
 - Ujësjiellësi i Vlorës
 - Drejtoria Rajonale e Pyjeve
 - Autoritetet përgjegjëse për shfrytëzimin e tokës (rregullime territoriale, planifikimi urban, departamentet rajonale të pyjeve dhe kullotave)
 - Bashkia e Vlorës
- Komuniteti Lokal
 - Përfaqësues të institucioneve për kujdesin ndaj shëndetit
 - Përfaqësues të turizmit, industrisë, energjisë, peshkimit, transportit, biznesit
 - Përfaqësues të institucioneve të edukimit
 - Përfaqësues të OJQ-ve lokale
 - Përfaqësues të biznesit
- Media
- Qendra Kombëtare Shkencore për Hidrokarburet

2.2 Konsulta me komunitetin

Projekti nisi për herë të parë në Shqipëri në mesin e vitit 2001 dhe PIR vendosi të fillojë kontaktet dhe diskutimet me Autoritetet e Qeverisë Qendrore që prej tremujorit të parë të vitit 2002. Që nga ajo kohë, ideja e ndërtimit të një Terminali të pavaruar është paraqitur në takime të ndryshme me administratën qendrore dhe lokale si edhe me komunitetin. Të gjitha sugjerimet, komentet dhe shqetësimet e identifikuara dhe të shfaqura nga grupet e interesit u morrën parasysh në një stad të hershëm të procesit të projektimit kur kishte më shumë mundësi për të ndikuar mbi përfundimet. Menjëherë pas prezantimit Autoriteteve të Qeverisë

Shqiptare të propozimit për ndërtimin e një Terminali të pavarur në Vlorë, projekti themelor u prezantua plotësisht gjatë takimeve me administratën qendrore dhe lokale dhe të gjitha sugjerimet dhe komentet e prezantuara në këto takime u morën parasysh për projektimin e mëtejshëm të detajuar të projektit. Gazeta të ndryshme paraqitën projektin në fjalë në disa artikuj në pranverën e vitit 2003 pasi projekti iu prezantua Zyrës së Kryeministrit.

Gjatë vitit 2004 projekti përfundimtar iu prezantua në detaje të gjitha palëve të interesuara dhe u zhvillua një diskutim i hapur me to më:

- 12 Mars me rastin e konferencës “Vlora, në krye të zhvillimit ekonomik” e organizuar nga Këshilli i Ministrave, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë, Dhoma e Tregtisë e Vlorës dhe Bashkia e Vlorës ku morën pjesë Kryeministri i Shqipërisë, anëtarë të Qeverisë, Kryebashkiaku i Vlorës dhe përfaqësues të rëndësishëm të komunitetit të Vlorës dhe biznesit.
- 26 Tetor, në një takim me përfaqësues të Ministrive të Mjedisit, të Industrisë dhe Energjisë dhe të Transportit (së bashku me “Insitutin e Transportit”, degën e saj teknike) dhe disa ekspertë të pavarur shqiptar me shumë eksperiencë në fushën e projektimit të infrastrukturës detare.
- 27 Tetor, në një takim me përfaqësues të Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve në Fier.
- 27 Tetor, në një takim me zyrtarë të Portit të Vlorës, zyrës së Kapitenerisë dhe Drejtorin e Ujësjellësit të Vlorës.
- 15 Dhjetor, në një konsultë me publikun me Komunitetin e Vlorës ku morën pjesë një numër i madh përfaqësuesish nga Bashkia (përfshirë edhe Kryebashkiakun), zyra të qeverisë dhe shumë ekspertë të kualifikuar të shoqërisë civile.

Një takim i dytë me Komunitetin e Vlorës u zhvillua me vonë më 23 Gusht 2005.

Detajet e takimeve të konsultave me publikun, pjesëmarrësit dhe minutat për secilin takim janë të paraqitura në Aneksin 17 të Raportit të VNM-së.

Për më tepër dhe si përfundim, gjatë dy muajve të fundit të 2006 u zhvillua një fushatë informuese shumë intensive nëpërmjet gazetave dhe rrjeteve TV kombëtare dhe lokale, artikujve të ilustruar, reklamave dhe intervistave me një përfshirje të gjerë dhe pozitive të publikut si në nivel kombëtar ashtu edhe lokal.

Media e shkruar dhe elektronike (kombëtare dhe lokale) ka ndjekur nga shumë afër ngjarjet e përmendura më sipër dhe i kanë pasqyruar ato vazhdimisht duke pajisur të gjitha grupet e interesuara të shoqërisë shqiptare me informacion të gjerë mbi zhvillimin e projektit të PIR.

Një program i plotë televiziv mbi Projektin e Terminalit Bregdetar për naftë, GLN, produkte të tjera të lëngshme dhe produkte të tjera u përgatit nga stacioni televiziv shqiptar NEWS 24. Gazetari i mirënjohur si një ekologjist i vendosur Ilir Mati vizitoi Terminalin PIR në Ravenna dhe prezantoi tiparet e Terminalit të ri që PIR do të ndërtojë në Shqipëri duke e krahasuar me atë në Ravenna. Programi u transmetua vazhdimisht gjatë ditës së Mërkurë, 3 Qershor 2004.

Të gjitha ngjarjet publike të përmendura më lart të organizuara nga La Petrolifera Italo-Albanese dhe ngjarjet në të cilat mori pjesë kompania së bashku me pasqyrimin e tyre në media e bënë shumë të njohur Projektin e Terminalit Bregdetar në Gjirin e Vlorës dhe lejuan që kompania të mbledhë të gjitha sugjerimet e vlefshme të shprehura nga komuniteti dhe insitucionet e ndryshme të interesuara, sidomos ato të angazhuara për mbrojtjen e mjedisit, dhe t'i përfshijë ato në Projektin Përfundimtar.

2.3 Draft i bërjes publike të VNM-së

Informacione mbi Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (“VNM”) dhe konsultën me publikun do të bëhen publike për të paktën 60 ditë në vendet e mëposhtme:

- Përmbledhje e shkurtër në gazeta;
- Në faqen e internetit të Operatorit;
- VNM i plotë në Bashkinë e Vlorës, Zyra e Mardhënieve me Publikun;
- VNM i plotë në [Business Information Centre](#), BERZH, Londër.
- VNM i plotë Zyrën e BERZH-it në Tiranë.

Në qoftë se do të jetë e nevojshme, palët e prekura do të kontaktohen gjatë bërjes publike të Projektit dhe çështjet dhe komentet e shprehura nga to do të përfshihen në raportin përfundimtar të VNM-së nëse mendohet e arsyeshme.

3 MEKANIZMI I ANKESAVE

Për të siguruar që të gjitha ankesat nga komuniteti lokal të shqyrtohen në mënyrë të përshtatshme, veprimet korrigjuese të zbatohen dhe ata që ankohen të njoftohen mbi përfundimet. Ky mekanizëm do të jetë i zbatueshëm për të gjitha ankesat e paraqitura nga komunitetet që preken nga projekti. Të gjitha ankesat, si ato verbale ashtu edhe ato të shkruara, duhet të regjistrohen në Ditarin e Ankesave. Ditari i Ankesave do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- Datën kur ankesa u raportua;
- Informacionin që ju nis palës që u ankua rreth veprimit korrigjues të propozuar (nëse është e përshtatshme);
- Datën kur u mbyll ankesa; dhe
- Datën kur ju kthye përgjigje palës që u ankua.

Do të ketë një person përgjegjës për çdo ankesë dhe ky person do të garantojë që të gjitha veprimet janë kryer për të mbyllur ankesën.